

AKT THEME LIMI DHE STATUTI I SHOQUERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Zest Creative Studio” SH.P.K

Sot me date 26/10/2023 :

- Rina Palaku, atesia Agron , shtetas Shqipetar lindur me 21/02/1994 ne Fier, banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me J45221071H;

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjt nr. 9723, dt. 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tone te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA
NENI. 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

Sot ne date 26/10/2023,u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“Zest Creative Studio” SH.P.K

1. Themeluesit e shoqerise jane :

- Rina Palaku, atesia Agron , shtetas Shqipetar lindur me 21/02/1994 ne Fier, banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me J45221071H;
NENI. 2
OBJEKTI I SHOQUERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

Organizim, menaxhim dhe produksion ekzekutiv eventesh të ndryshme kulturore dhe artistike, brenda dhe jashtë vendit. Ofrimi i shërbimeve në fushën e teknologjisë, muze digital, VR, studio podcast, realizim i produkteve audiovizive, post produksion, software etj. Sherbime marketingu, fushata promocioanle dhe menaxhim i rrjeteve sociale. Shkrim projektesh, plane biznesi dhe shërbimi i ofrimit të ekspertizës, konsulencës dhe realizimi i studimeve të ndryshme. Realizim shfaqjesh dhe eksposita të ndryshme artistike, koncerte, panaire, konferanca, takime, skenografi dhe dekor. Organizim aktivitetesh kulturore qe lidhen me promovimin e kultures, turizmit, trashegimine kulturore, organizim festivalesh, ofrimi i kateringut, mikpritjes dhe shërbimeve të ngjashme për evenete.



Ofrimi i shërbimeve në fushën e dizajnit grafik, dizajn web dhe shërbime të tjera kreative përmes materialeve dhe evenete marketingu, realizim logo dhe permbajtje grafike, projeksion, ekran dhe projektor me qera si dhe shërbime në fushën e kinematografisë. Shërbime paisje fonie, skene dhe ndricimi, materiale promocionale, fletpalosjesh, printim banerash, roll up etj. Tregëti, dhënie me qera dhe shitje të materialeve të dekorit dhe materialeve logistike përmes eventet, sallave dhe aparaturave teknike përmes prodhime audiovizuale. Cdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme përmes realizimin e qëllimit të Shoqerisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tanj per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI. 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne një afat te papercaktuar
Shoqeria mund te prishet perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI. 4

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit "Kullat Binjake" kati 2, nr. 26 Tirane.

KREU II

KAPITALI

NENI. 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 100.000(njeqind mijë) leke i perbere nga një kuote.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga 1 (një) kuote me vlerë nominale 100.000 leke nga Ortaku :

- Rina Palaku, atesia Agron , shtetas Shqipetar lindur me 21/02/1994 ne Fier, banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me J45221071H; zoteron 100% te kuotes me vlerë 100.000 leke.

Kontributet e ortakeve mund te jene ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI. 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te

kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI. 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoquerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE
NENI. 8
ORGANET VENDIMMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendor ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese



m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti
Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak
tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqsues i
ortakeve ne asamblene e per gjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila
perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes
elektronike. Njoftimi duhet te permboje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u
dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e
asamblese

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime
te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullslse.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme
mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30
% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te
kualifkuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime
te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te
pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo injete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te
nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e per gjithshme, mblidhet
perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e per gjithshme vodos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres,
per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve,
riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vodos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padje ndaj tij nga shoqeria

- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga një perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jetë ne te njejtin konfikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13
ADMINISTRIMI

Asambleja e per gjithshme emeron një ose me shumë persona fizike si administratore të shoqerise. Afati i emerimit, është 5 vjet me të drejtë riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Personi i me poshtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur të drejtë të pakufizuarë administrimi.

- Rina Palaku, atesia Agron, shtetas Shqipetar lindur me 21/02/1994 në Fier, banuase në Tirane, me dokument identifikimi me J45221071H;

NENI 14
KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratorët kane të drejtë dhe detyrohen të:

- a) Kryejne të gjitha veprimet e administrimit të vendosura nga asambleja e per gjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen për mbajtjen e sakteve të rregullt të dokumentave dhe librave kontabel të shoqerise
- d) Përgatitshmëri dhe nenshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimitarëve dhe se bashku me propozimet për shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asambleje se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojnë një sistem paralajmerimi në kohen e duhur për rrëthanat, që kercenojne mbarevajtjen e veprimitarëve dhe ekzistencën e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojnë dhënët e detyrueshme të shoqerise, sic parashikohet në ligjin per Qendren Kombetare të Regjistrimit
- g) Raportojnë para Asambleje se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe të veprimeve të posacme me rendesi të vecante për veprimitarët e shoqerise
- h) Kryejne detyra të tjera të parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e per gjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejtë.

NENI 15
PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori është per gjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj të tretave, per shkelje të ligjeve, per shkelje të statutit, apo per faje të kryera gjate admInIstrImIt të shoqerise.



Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane perjegjes per demet e sjella shoqerise dhe perjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.

2. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV
VITI FINANCIAR -EKSPERTET
NENI 16
VITI FINANCIAR

Viti finaciar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtmisht , viti i pare finaciar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllte me 31 dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finaciar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU 5
PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjt mbi shoqerite tregtare.

ART. 20

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me perjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoperi qe ushtron aktivitet ne te njeften fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anullohet ne asamblene e pare te pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 21 LEGJISLACIONI


Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22 MOSMARREVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 2 kopje ne gjuhen shqipe, me vlore te njezte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Arben Xhaçka". The signature is fluid and cursive, with the name "Arben" on top and "Xhaçka" below it, enclosed in a large, sweeping flourish.